



Data: 15.11.2024

SHPLLJE PËR APLIKIM

për një (1) profesor /ekspert të jashtëm për anëtarë të Komisionit të Pranimit në Institucionin tjetër shtetëror për pozitën: Zyrtar Kadastral - Nr. REF RN00015478;

Divizioni i Burimeve Njerëzore në Agjencinë Kosovare të Privatizimit, në pajtim me dispozitat e nenit 42 paragrafit 2.3 të Ligjit Nr. 08/L-197 për Zyrtar Publik dhe nenit 21 paragrafi 3 të Rregullores (QRK) nr.15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil fton të gjithë ekspertët e jashtëm (ofruesit jo publik të shërbimeve të punësimit, OJQ-të dhe/apo kompanitë e regjistruara në Republikën e Kosovës në fushën e burimeve njerëzore) të dërgojnë ekspertët e tyre për anëtarë të mundshëm të Komisionit të Pranimit në Institucionin tjetër Shtetëror.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

Eksperti i jashtëm do të jetë anëtar të Komisionit të Pranimit në kuadër të Agjencinë Kosovare të Privatizimit dhe duhet t'i plotësojnë kriteret si më poshtë:

Kriteret e kërkuara:

- Të kenë diplomë universitare të paktën 240 kredi, kurse për diplomat e marra jashtë vendit, nevojitet nostrifikimi;
- Të kenë tetë (8) vite përvojë pune profesionale prej të cilave të paktën pesë (5) vite në pozita të nivelit drejtues;
- Të mos kenë qenë anëtarë të organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën në pesë (5) vitet e fundit;
- Të kenë integritet moral dhe profesional;
- Të mos kenë aktakuzë të konfirmuar dhe të mos kenë qenë të dënuar për kryerjen e një vepre penale;
- Të mos jetë i punësuar në shërbimin civil, të mos jetë i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos kenë masa disiplinore në fuqi.

Pagesa:

Anëtari i Komisionit si ekspert i jashtëm në Komisionin e Pranimit, përfiton një pagesë fikse prej dyqind e pesëdhjetë (250.00) Euro për çdo procedurë të rekrutimit në të cilën merr pjesë në përputhje me nenin 21 paragrafi 4 të Rregullores (QRK) nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimit në Shërbimin Civil.



Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit:

Kandidatët duhet ti dorëzojnë edhe dokumentacionet si më poshtë:

- CV-në;
- Dëshminë e kualifikimit profesional (diplomën e fakultetit). Për edukimin e marrë jashtë vendit duhet të bashkëngjitet nostrifikimi i diplomës;
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Dëshmi për përvojën e punës;
- Dëshmi që nuk ka aktakuzë të konfirmuar dhe nuk është i dënuar për kryerjen e një vepre penale;
- Deklaratën se nuk ka qenë anëtarë i organeve drejtuese të ndonjë partie politike të paktën pesë (5) vitet e fundit;
- Deklaratën se nuk është i punësuar në shërbimin civil, se nuk është i larguar nga shërbimi civil si rrjedhojë e masave disiplinore dhe të mos ketë masa disiplinore në fuqi.

Ekspertët e jashtëm mund të aplikojnë përmes postës elektronike dhe dokumentet e kërkuara t'i dorëzojnë në Agjencinë hr@pak-ks.org

Për të gjithë të interesuarit ofrohen mundësi të barabarta dhe inkurajojmë ekspertët e jashtëm që të aplikojnë me kandidatët që i plotësojnë kriteret e shpalljes.

Shpallja mbetet e hapur nga data 15/11/2024 deri më 22/11/2024 në ora 16:00.

Për informata shtesë ose sqarime mund të kontaktoni në e-mail adresën: hr@pak-ks.org